

## **Akt Thmelimi i shoqërise tregtare “ATMC” Sh.P.K**

**Bazuar** në ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “ për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” dhe ligjin 9723 dt.03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërise, me vullnetin tim të lire:

**Önder SAYIN e Dtl. 06.11.1976** lindur ne Turqi dhe banues në Turqi me pashaporte nr. **U24785126**

### **Formimi**

#### **Neni 1**

Sot më Dt. 19/12/2023 Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**ATMC**” **Sh.P.K.**

Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar , ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega . Shoqëria do të ushtrje veprimtarine e saj në bazë të ketij akti themelues dhe statutit të shoqërise që do të miratohet nga ortakët themelues .

### **Selia e Shoqërise**

#### **Neni 2**

Selia e shoqërise tregtare private “**ATMC**” **Sh.P.K** do të ketë seline në. **Elbasan, fshati Bradashesh, rruga Elbasan-Bradashesh km-5, Kombinati Metalurgjik, zk.3965, pasuria nr.1124.**

Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , të hape zyra përfaqësie , degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërise , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakeve të shoqërise.

#### **Neni 3**

### **Objektivi i Veprimtarisë**

Në fushën e tregtisë dhe të karakterit të përgjithshem: Import-eksport, tregtim dhe prodhim me shumicë dhe pakicë të makinerive dhe pajisjeve që përdoren për

guroret dhe minierat, për fushën inxhinierike e mekanike, sonda dhe pajisje të cdo lloj për punimet shpimeve e kërkimeve gjeodezike e gjeologjike, për punimet topografike e sizmike, të fizibilitetit të tokës etj, për punimet e ndërtimit dhe rikonstruksione, për ndërmarrjet industriale, veprave të ndryshme teknike apo të infrastruktures, mallra industriale dhe ushqimore dhe lëndë të para, Kryerja e shërbimeve të ndryshme inxhinieriko-mekanike. Shitje blerje me shumice dhe pakice i vajrave, graso, additive dhe nënprodukte të tyre. Ndërtime rruge kategoria e I,II,III,IV,V, rruge speciale, veshje asfalto betoni të rrugëve. Ndërtime ujësjellësa dhe kanalizime. Kryej rolin e komisionerit apo të ndërmjetësit tregtar, të hap zyra përfaqësimi si brenda vendit ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Dhënie me qera personave të tretë, personave fizikë ose personave juridikë. Hapje linjash të ndryshme prodhimi, etiketim, ambalazhim, numërim, peshim mallrash konfeksioni dhe tekstili, industriale, ushqimore etj.

## **Kohezgjatja e Shoqërisë**

### **Neni 4**

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat më shumë se **10-vjetë** . Ajo mund shpërbehet në cdo kohë dhe për çfardo lloj shkakut .

## **Kapitali i Shoqërisë**

### **Neni 5**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 (Njëqind mijë lekë)**.

2.Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem:

a. Ortaku themelues **Önder SAYIN** Zotëruese i **1 kuote** me vlerë të përgjithshme **100 000 (Njëqind mijë lekë)**, që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

## **Drejtimi i Shoqërisë**

### **Neni 6**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj **Z. Marenglen Mema** për një periudhë **5-vjecare**. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie më të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .



Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqesues i pajisur me prokurë të posacme .

#### **Neni 7**

Të ardhurat neto të shoqërise i takojnë ortakëve të shoqërise.

#### **Neni 8**

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë të emëroje dhe administratorë të tjerë të vlerave material, ka të drejtë të caktojë financiere , likuidator për problemet e shoqërise si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë .

#### **Neni 9**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar .

#### **Neni 10**

Shoqëria ka vulen e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

#### **Neni 11**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe ne përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

#### **Neni 12**

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje , për t'ju shpërndarë organëve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin baze të shoqërise “**ATMC**” **Sh.P.K.** Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërise.

**Ortaku i vetëm i shoqërisë “ATMC” Sh.P.K.**

**Önder SAYIN**

